



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1200 Prot.

Tiranë, më 24. 11 2016

VENDIM Nr. 128, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi *Konceptin e ndërhyrjes arkeologjike në kuadër të projektit "Zbatimi i sheshit publik para hyrjes së Portit Durrës"*, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë (QSA),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin e ndërhyrjes arkeologjike në kuadër të projektit "Zbatimi i sheshit publik para hyrjes së Portit Durrës"*, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.(QSA) sipas përcaktimeve të mëposhtme:
 - Për zonën Nr. 1, punimet e gërmimit të kryhen nën monitorimin e Institutit të Arkeologjisë, me qëllim përfitim të një informacioni në lidhje me potencialin arkeologjik të kësaj zone.
 - Për zonën Nr. 2, të realizohen nga Instituti i Arkeologjisë 4 sondazhe arkeologjike sipas konceptit të paraqitur nga ky Institut.
 - Për zonën Nr. 3, të kryhet gërmimi arkeologjik nga Instituti i Arkeologjisë, në të gjithë gjatësinë e fortifikimit prej 75 m, me gjerësi 7 deri në 10m si dhe të realizohen dy sondazhe në pjesën perëndimore të Kullës Veneciane.
 - Në zonën Nr. 3, nuk miratohet kryerja e sondazhit arkeologjik në rrugën e Dëshmorëve, pranë kullës Veneciane.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me Institutin e Arkeologjisë që do të kryejë dhe monitorojë punimet e sipërpërmendura, për këtë projekt dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, që do të realizojë mbikqyrjen e tij.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO EURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO

